



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1011-1/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevcu kryesues, Rafet Haxhaj dhe Afijete Sada Gllogjani anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, përkitazi me apelin e parashtruar nga Shkelzen Shala, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 datë 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli Prishtinë, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të Kuvendit Komunal, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, duke vepruar sipas detyrës zyrtare për ta korrigjuar vendimin e PZAP-it, ZL.Anr.1011/2017 të datës 12.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Korrigjohet Vendimi i PZAP-it, me shenjë ZL.Anr.1011/2017 i datës 12.11.2017, në faqen e parë pasusi i tretë, **ashtu që në vend të** Bardh Topalli, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik (AKR), me seli në Prishtinë dega në Ferizaj, me të cilën ka pretenduar se vendvotimet 2506D, 2526D dhe 2512D votat e tij i janë bartur kandidatëve të tjerë, **duhet të jetë** Shkelzen Shala, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, me të cilën ka pretenduar se në vendvotimet 0916E/01D, 0912E/02D, kanë votuar familjarët e tij dhe votat e tyre nuk kanë dal.

Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit ZL.Anr.1011/2017 i datës 12.11.2017 dhe pjesë tjera të vendimit mbesin të pa ndryshuara.

A r s y e t i m

Me rastin e hartimit të vendimit të PZAP-it, ZL.Anr.1011-1/2017 të dt. 12.11.2017, në faqen e parë, në pasuesin e tretë është shkruar gabimisht Bardh Topalli, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik (AKR), me seli në Prishtinë dega në Ferizaj, me të cilën ka pretenduar se vendvotimet 2506D, 2526D dhe 2512D votat e tij i janë bartur kandidatëve të tjerë e që do të duhej të jetë Shkelzen Shala, kandidat për anëtar të

Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, me të cilën ka pretenduar se në vendvotimet 0916E/01D, 0912E/02D, kanë votuar familjarët e tij dhe votat e tyre nuk kanë dal.

Duke e vërejtur këtë gabim e lartpërmendura, paneli bëri korrigjimin e vendimit ZL.Anr.1011/2017 i datës 12.11.2017, ashtu siç është shënuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Me sa u tha më lartë, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenit 165 të LPK- së.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1011/1-2017 më datën 18.11.2017

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevci



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi ankesa nuk është e lejuar.